



Republika e Kosovës – Република Косово – Republic of Kosovo

Qeveria – Влада – Government

Zyra e Kryeministrit – Канцеларија премијера – Office of The Prime Minister

Zyra e Komisionerit për Gjuhët – Канцеларија повереника за језике

Office of the Language Commissioner

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2017

Prishtinë, 2018

MISIONI

Ndërtimi i një mjedisi institucional që respekton detyrimet kushtetuese dhe ligjore, mbron, promovon, ruan dhe zbaton të drejtat gjuhësore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Fjalë hyrëse

Të nderuar,

Para jush është raporti i katërt vjetor i Zyrës së komisionerit për gjuhët, e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Viti pas nesh është edhe një vit tjetër i punës intensive dhe veprimit aktiv për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat gjuhësore të të gjitha komuniteteve në Kosovë, si dhe për të përmirësuar zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve në përputhje me mandatin dhe kompetencat që përcaktohen me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

Zyra e komisionerit për gjuhët më punën e saj i është dedikuar parimeve të demokracisë dhe sundimit të ligjit dhe përpiqet të punojë në mënyrë aktive në fushën e ruajtjes dhe promovimit të të drejtave gjuhësore të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Zyra gjatë vitit 2017, përmes formave të ndryshme të bashkëpunimit ndërinstitucional të përcaktuar me Kushtetutë dhe Ligj, monitoroi dhe mbikëqyri zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve në institucionet në nivel qendror dhe lokal dhe veproi sipas ankesave të bëra nga qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile dhe personat tjerë juridik.

Përkundër faktit që jemi në komunikim të vazhdueshëm me institucionet të cilave iu dërgojmë rekomandimet përmes të cilave kërkojmë zbatimin e plotë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, gjetjet që kanë dalë nga aktivitetet që i kemi bërë në vitin e kaluar, nxjerrin në pah se zbatimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve në institucione nuk është përmirësuar shumë dhe kjo çështje kërkon shumë më tepër angazhim dhe përkushtim.

Efikasiteti i dobët i organeve të administratës publike në Kosovë në sigurimin e qasjes së barabartë në shërbime në të gjitha gjuhët zyrtare, kërkon ndërmarrjen e masave të ndryshme të parashikuara me Ligj, të cilëve Zyra do t'i përkushtohet veçanërisht në periudhën e ardhshme dhe për këtë do të informojë publikun me kohë.

Një segment të rëndësishëm të punës së Zyrës paraqet edhe puna në promovimin dhe rritjen e dukshmërisë dhe qasshmërisë së kësaj zyreje në tërë territorin e Kosovës, si dhe në përmirësimin e qasjes dhe transparencës së punës së saj. Duke marrë pjesë në debate dhe punëtori të shumta publike në mbarë Kosovën, duke organizuar takime dhe punëtori të tilla, vazhdimisht duke plotësuar përmbajtjen e faqes zyrtare të internetit dhe duke kryer shumë aktivitete të tjera, Zyra është përpjekur ta informojë publikun për rolin, detyrat dhe autorizimet e veta. Është përpjekur t'i ndihmojë qytetarët që të njohin shkëlqen e të drejtave të tyre dhe t'i inkurajojë ata që të reagojnë dhe të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave gjuhësore të garantuara me Kushtetutë dhe Ligj. Që të arrihet e gjithë kjo, kemi bashkëpunuar me sukses me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare dhe vendore, si dhe me organizatat e shoqërisë civile dhe mediat.

Në vazhdim mund të lexoni Raportin në të cilin kemi dhënë një pasqyrë të detajuar të të gjitha aktiviteteve të ndërmarra, si dhe një numër rekomandimesh për institucione të caktuara.

Në fund, ftoj të gjitha institucionet publike që, në bashkëpunim me Zyrën, organizatat e shoqërisë civile dhe akterët tjerë shoqërorë, të intensifikojnë punën në promovimin dhe ruajtjen e të drejtave gjuhësore në Kosovë dhe në krijimin e kushteve për funksionim efikas dhe efektiv të sistemit të mbrojtjes së të drejtave gjuhësore.

Zbatimi i suksesshëm i Ligjit për përdorimin e gjuhëve, nënkupton veprimin afatgjatë, të përkushtuar dhe të koordinuar të të gjithë akterëve shoqërorë dhe Zyra do t'i përkushtohet këtij qëllimi në periudhën e ardhshme.

Me respekt,

Slaviša Mladenović

Komisioner për gjuhët

PËRMBAJTJA

Misioni

Fjala hyrëse

SHKURTESAT

MBI RAPORTIN

ROLI DHE MANDATI I ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR GJUHËT

MEKANIZMAT MBËSHTETËS TË ZYRËS

PJESA I

ZBATIMI I PËRPUTHSHMËRISË, MONITORIMI DHE NGRITJA E KAPACITETEVE

- Unifikimi i librezave të automjeteve
- Udhëzues për rolin e rrjetit për politika të gjuhëve
- Rregullimi i formularëve të MAP-it
- Përdorimi i gjuhëve në KQZ
- Procedura për emërimin e anëtarëve të rinj të Bordit për Politika të Gjuhëve
- Monitorimi i akteve ligjore në të dy gjuhët, përmes platformës online të ZKM-së
 - Aktet e kontrolluara përmes platformës për konsultime.
- Mjeti monitorues për komunat
- Komisioni për monitorimin e subvencioneve dhe transfereve
- Hartimi i librave për mësimin e gjuhëve zyrtare për zyrtarët komunal
- Kurset e gjuhëve zyrtare në komuna
- Trajnimi i trajnerëve të Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP)
- Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës
- Bashkëpunimi me Drejtoratin e përgjithshëm për përkthime (DGT) të Komisionit Evropian

PJESA II

HETIMI DHE NDËRMJETËSIMI

- Veprimet të cilat ndërmerren nga Zyra, pas marrjes së ankesave
- Procedura hetimore pas vendosjes së Komisionerit për gjuhët që të zhvillohen hetimet
- Aplikacioni "Language Officer"
- Ankesat e pranuar gjatë vitit 2017
- Shqyrtimi i ankesave
- Disa nga çështjet e parashtruara

PJESA III

INFORMIMI DHE DUKSHMËRIA

- Vetëdijesimi i institucioneve dhe qytetarëve për zbatimin e Ligjit
 - Ftesa për propozime të projekteve
- Dita evropiane e gjuhëve
- Debate me qytetarë dhe institucione
- Paraqitjet mediale
- Faqja zyrtare e internetit
- Bashkëpunimi me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë

REKOMANDIMET

- Zbatimi i rekomandimeve

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2018

SHKURTESAT

AKB (AKT) - Avancojmë Kosovën së Bashku
AKPPM - Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
AKSP - Akademia e Kosovës për Siguri Publike
ARC - Agjencia e Regjistrimit Civil
BPGJ - Bordi për Politika të Gjuhëve
DASHC - Departamenti i Administratës së Shërbimit Civil
DGT- Drejtoria e Përgjithshme e Përkthimeve
QAK-Qendra e Automjeteve të Kosovës
DPP - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
ECMI - Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve - Kosovë
IKAP - Instituti i Kosovës për Administratë Publike
LPGJ- Ligji për përdorimin e gjuhëve
KE-Komisioni Evropian
KKK - Këshilli Konsultativ për Komunitete
HCNM- Komisioneri i Lartë për Pakica Kombëtare me seli në Hagë
CSD - Komunikimi për Zhvillimin Social
MAP - Ministria e Administratës Publike
MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD - Ministria e Drejtësisë
MeD - Ministria e Diasporës
MF - Ministria e Financave
MFSK - Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
MI - Ministria e Infrastrukturës
MIE - Ministria e Integriteteve Evropiane
MKK - Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPH - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB - Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ - Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH - Ministria e Shëndetësisë
MTI - Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë
MZHE - Ministria e Zhvillimit Ekonomik
OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PK - Policia e Kosovës
RRPGJ - Rrjeti për Politika të Gjuhëve
USAID - Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
EUSR - Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë/Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë
ZKGJ - Zyra e Komisionerit për gjuhët
ZKM - Zyra e Kryeministrit

MBI RAPORTIN

Ky raport ka për qëllim informimin e opinionit të gjerë dhe të gjitha palët me interes për punën, të arriturat dhe sfidat e ZKGJ-së, në procesin e sigurimit të zbatueshmërisë së Ligjit nr.02/L-37 për përdorimin e gjuhëve (më tutje Ligji).

Raporti paraqet punën e Zyrës gjatë vitit 2017 dhe përmban informacione:

- për projektet e zhvilluara me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve dhe institucioneve, nivelin e zbatueshmërisë së Ligjit,
- këshillat ligjore të Zyrës për institucionet,
- ankesat e pranuar dhe shqyrtimin e tyre,
- rekomandimet e dhëna përfshirë edhe zbatimin e atyre paraprake.

ROLI DHE MANDATI I ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR GJUHËT

Përmes komponentës së shqyrtimit legjislativ dhe sigurimit të përputhshmërisë së ligjeve të tjera me Ligjin për përdorimin e gjuhëve, Zyra në vazhdimësi monitoron dhe raporton për respektimin e këtij Ligji nga institucionet nën juridiksionin e saj.

Zyra shqyrton, vlerëson dhe ofron rekomandime për projektligjet, për të siguruar përputhshmërinë me Ligjin.

Zyra, gjithashtu rekomandon miratimin e legjislacionit që mund të jetë i nevojshëm për të ngritur nivelin e zbatimit të Ligjit. Shqyrton dhe bën rekomandime përkitazi me rregulloret apo udhëzimet administrative në kuadër të Ligjit, për sa i përket përputhshmërisë dhe konsistencës së cilitdo akt legjislativ. Përmes kësaj komponente, ofron rekomandime për zhvillimin e kapaciteteve, si dhe nevojën e ndarjes së buxhetit dhe resurseve njerëzore të caktuara për zbatimin e Ligjit.

Kryen hetime, qoftë me iniciativën e vet, qoftë në bazë të ankesave të bëra nga një person fizik apo juridik. Ofron, kur duhet, këshilla apo ndihmë për publikun në lidhje me të drejtat e tyre gjuhësore sipas Ligjit, si dhe ofron ndihmë për institucionet nën juridiksionin e saj për sa u përket detyrimeve të tyre.

Ndihmon Qeverinë në zhvillimin e programeve të vetëdijesimit publik ose i zhvillon vetë ato. Zhvillon aktivitete të rregullta kontaktuese me publikun për të informuar opinionin e gjerë rreth detyrimeve të institucioneve për zbatimin e Ligjit, si dhe të drejtat e qytetarëve për sa u përket çështjeve gjuhësore të përcaktuara me Ligj.

MEKANIZMAT MBËSHTETËS TË ZYRËS

Bordi për politika të gjuhëve – Siguron mbështetje institucionale për zhvillimin, zbatimin dhe fuqizimin e politikave për gjuhët. Bordi përbëhet nga njëzet (20) anëtarë, të cilët përfaqësojnë institucionet që ofrojnë shërbime, si dhe nga përfaqësues të komuniteteve gjuhësore.

Rrjeti për politika të gjuhëve - Anëtarët e rrjetit ndihmojnë ZKGJ-në në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve. Rrjeti përbëhet nga personat kontaktues të emëruar nga të gjitha institucionet, nën juridiksionin e Zyrës dhe asistentët gjuhësorë.

SIGURIMI I ZBATUESHMËRISË SË LIGJIT

ZBATIMI I PËRPUTHSHMËRISË, MONITORIMI DHE NGRITJA E KAPACITETEVE

Monitorimi i institucioneve, ka kërkuar angazhim dhe përkushtim të cilin Zyra edhe përkundër vështirësive, e ka zbatuar me përgjegjësi. Përveç trajtimit të çështjeve të caktuara, me avancimin e teknologjisë informative janë ofruar kushte më të përshtatshme për monitorimin e përputhshmërisë së legjislacionit me LPGJ-në.

Përveç kësaj janë monitoruar edhe rekomandimet të cilat Zyra e Komisionerit për gjuhët i ka dhënë institucioneve gjatë vitit paraprak.

Po ashtu, Zyra në vazhdimësi jep këshilla dhe opinione ligjore, sipas kërkesës, kështu që gjatë vitit 2017 janë dhënë një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve përmes formave të ndryshme. Në raste të caktuara janë përsëritur, kur është vërejtur se nuk janë zbatuar të njëjtat.

Unifikimi i librezave të automjeteve

ZKGJ-ja ka punuar në unifikimin e librezave të automjeteve, respektivisht ka rregulluar emërtimet në të dy gjuhët. Ky aktivitet është zhvilluar pas pranimit të ankesës se versioni në gjuhën serbe është i paqartë. Zyra ka dhënë përkrahje përmes ekspertizës, për të rregulluar gjuhësisht edhe aplikacionet. Si sfidë mbetet versioni i ri i aplikacioneve, të cilën ARC ende nuk e ka rregulluar për shkaqe objektive.

Udhëzues për rolin e rrjetit për politika të gjuhëve

Së bashku me OSBE-në është zhvilluar projekti për përpilimin e një dokumenti i cili përcakton apo qartëson detyrat dhe obligimet e anëtarëve të Rrjetit për politika të gjuhëve. Në kuadër të kësaj, janë mbajtur katër punëtori me anëtarët e RPPGJ (komunat, agjencitë, ministritë dhe ndërmarrjet), janë mbajtur takime të vazhdueshme të ZKGJ-së me OSBE-në dhe përfundimisht është arritur që të përpilohet **“Udhëzuesi për rolin e Rrjetit për politika të gjuhëve”**. Ky Udhëzues, do t’u shërbejë personave kontaktues, gjatë punës së tyre për çështjet gjuhësore dhe bashkëpunimit të tyre me ZKGJ-në.

Rregullimi i formularëve të MAP-it

Rregullimi i formularëve të MAP-it në aspektin gjuhësor ka qenë objektivë e ZKGJ-së gjatë dy viteve paraprake. Edhe përkundër insistimit nuk ka mundur të arrihet asgjë, për shkak të mosgatishmërisë së bashkëpunimit nga ana e MAP-it. Zyra e ka paraqitur këtë shqetësim disa herë, ka ofruar ekspertizën e vet, por prap kjo iniciativë ka mbetur e pareaalizuar. Lidhur me këtë, mbështetje ka ofruar edhe Zyra e Ambasadës Amerikane. Është mbajtur takimi për të trajtuar çështjen e projektit në fjalë. Janë dërguar tri shkresa zyrtare në MAP dhe janë mbajtur dy takime me përfaqësuesit e kësaj ministrie, por nuk ka pasur ndonjë përgjigje nga ta.

Përdorimi i gjuhëve në KOZ

ZKGJ-ja ka bashkëpunuar me KOZ-në për gjuhët zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtar nëpër komuna. Zyra ka dhënë rekomandime dhe këshillë ligjore, për sa i përket gjuhëve në përdorim zyrtar nëpër komuna. Nga rekomandimet për rregullimin e ueb faqeve, nga KOZ janë paraqitur një numër arsyesh për mos koordinim të gjuhëve, mbi të gjitha, nga mbingarkesa në punë, që pastaj çon deri te parregullsitë. ZKGJ-ja nuk e ka konsideruar këtë si justifikim dhe ka kërkuar që të ndërmerren hapa për realizimin e këtyre rekomandimeve. Është premtuar nga KOZ-ja se rekomandimet do të zbatohen domosdoshmërisht në vitin 2018.

Procedura për emërimin e anëtarëve të rinj të Bordit për politika të gjuhëve

Sipas Vendimit të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, nr.ref 115/2012, të datës 14 maj 2012, janë emëruar anëtarët e Bordit për politika të gjuhëve.

Bazuar në dispozitat e nenit 5 dhe 7 të Rregullores nr. 07/2012 për Zyrën e Komisionerit për gjuhët, Bordi për politika të gjuhëve përbëhet prej 20 anëtarëve, mandati i të cilëve zgjatë 4 vjet.

Kompetencat, përbërja, mandati i anëtarëve, zgjedhja e kryesuesit dhe zv/kryesuesit, rregullohet me nenin 3 të Rregullores së punës së Bordit.

Sipas kësaj dispozite, në Bordin për politika të gjuhëve përfaqësohen: Zyra e Kryeministrit, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Kuvendi i Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Njësia për Monitorim dhe Politika të Ndërmarrjeve Publike, Shërbimi Korrektues, Asociacioni i Komunave të Kosovës, Universiteti i Prishtinës dhe përfaqësuesit e komuniteteve gjuhësore si: gjuha shqipe, gjuha serbe, gjuha boshnjake, gjuha turke, gjuha rome, gjuha kroate, gjuha malazeze dhe gjuha gorane.

Meqenëse anëtarëve të Bordit të kësaj përbërjeje iu skadonte mandati më 14 Maj 2017, në shkurt të vitit 2017 Zyra ka filluar procedurën për emërimin e anëtarëve të rinj. Lidhur me këtë, anëtarët e Bordit, i informoi kryesuesi i Bordit, në mbledhjen e fundit të përbërjes së vjetër, duke potencuar se duhet filluar procedura e emërimit të anëtarëve të rinj. Zyra më pastaj ka njoftuar të gjitha institucionet relevante dhe ka kërkuar që të emërojnë nga një përfaqësues të ri, në mënyrë që të bëhet konstituimi i Bordit. Të gjitha institucionet i kanë dërguar emrat e anëtarëve me përjashtim të Zyrës së Kryeministrit e cila është vonuar me

emërimin e një anëtari. Për këtë arsye ZKGJ-ja nuk ka arritur ta konsolidojë Bordin deri pas formimit të Qeverisë së re, pas zgjedhjeve të qershorit 2017.

Pas formimit të Qeverisë së re, në afatin optimal Zyra e Kryeministrit ka dërguar emrin e përfaqësuesit të vet dhe janë përmbledhur të dhënat e anëtarëve të rinj. Është hartuar koncepti Vendimi për themelimin, gjegjësisht emërimin e anëtarëve të rinj të Bordit dhe është dërguar në Zyrën ligjore. Pas nënshkrimit të vendimit nga Kryeministri, është ftuar mbledhja informuese e Bordit, e cila u mbajt në dhjetor të vitit 2017.

Tanimë, Bordi për politika të gjuhëve është funksional dhe aktivitetet do të vazhdojnë menjëherë në fillim të vitit 2018, kur edhe do të bëhet zgjedhja e kryesisë së Bordit.

Monitorimi i akteve ligjore në të dy gjuhët, përmes platformës online të ZKM-së

Pas aktivizimit të platformës online për konsultim me publikun, me datën 22.02.2017, Zyra e Komisionerit për gjuhët ka filluar të monitorojë disa nga projekt-aktet normative të cilat janë në shqyrtim (debat publik).

Zyra e Komisionerit për gjuhët, platformën e konsideron si mundësi të mirë, përmes së cilës sigurohet një proces i komunikimit ndërmjet organeve publike, palëve të interesuara dhe publikut, për një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në procesin e politikë- bërjes dhe vendimmarrjes me interes publik, si dhe rritjen e transparencës në përgjithësi.

Duke shfrytëzuar mundësinë e platformës, Zyra e Komisionerit për gjuhët, pas monitorimit të një numri të projekt udhëzimeve administrative, projekt rregulloreve dhe projekt ligjeve, ka dhënë komente me rekomandime, të cilat iu janë dërguar institucioneve përmes platformës, si dhe drejtpërdrejt personave kompetentë nëpër institucione.

Zyra ka konstatuar se këto akte ligjore janë të vendosura në këtë platformë në të dy gjuhët dhe se këto versione në përgjithësi janë korrekte. Në ato raste kur Zyra ka konstatuar se ka gabime apo lëshime, janë shkruar komentet të cilat kanë të bëjnë me:

- gabime të konsideruara gjuhësore (gramatikore, sintaksore);
- përdorimi i shprehjeve dhe termeve në gjuhët e huaja, të cilat janë të pa qarta për gjuhët zyrtare në të cilat hartohen aktet normative;
- përdorimi i termeve dhe shprehjeve të ndryshme në gjuhën kroate dhe boshnjake, e që dallojnë nga termet në gjuhën serbe;
- në pikëpamje gjuhësore, ka raste kur emri i projekt-rregullores përdoret ndryshe nga emri i ligjit;
- ka mospërputhshmëri përmbajtjesore dhe kundërthënëse, të cilat shpesh dispozitën e aktit e bëjnë të paqarta dhe krijojnë mundësi të interpretimit të dyfishtë.

ZKGJ-ja ka dërguar komentet për secilin akt veç e veç dhe është duke monitoruar në vazhdimësi se a janë përfshirë komentet në versionet përfundimtare.

Aktet e kontrolluara përmes platformës për konsultime:

1. Projektligji për tatimin në pronën e paluajtshme;
2. Drafti i planit nacional i veprimtimit për personat me aftësi të kufizuara;
3. Projektligji për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare;
4. Projekt rregullore për detyrat, përgjegjësitë dhe procedurat e komisioneve të agjencisë kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës;
5. Projekt rregullore (MAPL) për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunave;
6. Udhëzim Administrativ (QRK) Nr.-----2017 për procedurat, kushtet dhe kriteret rreth përfundimit të administrimit të pronave nën administrim dhe atyre të përfshira në skemën e qirasë së agjencisë kosovare për hartim dhe verifikim të pronës;
7. Projekt Rregullore (MKRS) për kategorizimin e sportistëve dhe të trajnerëve;
8. Projekt Rregullore për detyrat, përgjegjësitë dhe organizimin e Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë;
9. Projekt Rregullore për hartimin dhe publikimin e akteve të komunës;
10. Rregullore e Këshillit të Akreditimit në tri gjuhë;
11. Udhëzim Administrativ Nr. XX - 2017 për pajisje dimërore;
12. Drafti i planit nacional për personat me aftësi të kufizuara 2017-2019;
13. Projekt Rregullore (QRK) Nr. ____2017 për detyrat, përgjegjësitë dhe procedurat e Komisioneve të Agjencisë kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës;
14. Projektligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës;
15. Pyetje me përgjigje të shumëfishta për procedurën e rekrutimit në shërbimin civil të Kosovës;
16. Udhëzimit administrativ me Nr.xx /2017 për dhënien e provimit për ndërrim të patentë shoferit të huaj;
17. Udhëzues Nr.____2010/MAP/DASHC për procedurat e kalkulimit, përcjelljes, shtypjen e listave të pagave dhe urdhër pagesave.

Mjeti monitorues

Zyra e Komisionerit për gjuhët me përkrahjen e OSBE-së ka krijuar një mjet monitorues (MM), për të bërë monitorimin e zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve në komunat e Republikës së Kosovës. Monitorimi është paraparë të bëhet i rregullt në baza vjetore. Mjeti është punuar nga eksperti i kontraktuar nga OSBE-ja dhe është finalizuar në fillim të vitit 2017. Për finalizimin e tij kanë dhënë kontribut edhe anëtarët e rrjetit nga komunat, përmes takimeve dhe konsultimeve të mbajtura, me ç' rast edhe janë familjarizuar gradualisht me të.

Komunat, respektivisht personat kontaktues të Rrjetit për politika të gjuhëve, janë të obliguar të bëjnë grumbullimin e të dhënave (nëpër drejtoritë komunale) dhe ta plotësojnë mjetin, i cili është krijuar si pyetësor.

Sipas planifikimit të aktiviteteve, ZKGI-ja e ka shpërndarë këtë mjet në fund të tetorit, së bashku me të edhe **UDHËZUESIN PËR PËRDORIM** me udhëzimet se si mund të plotësohet

pyetëson. Është kërkuar që në afat prej 15 ditësh pune, komunat respektive ta kthejnë të mjetin e plotësuar.

Problematika fillestare ka qenë që shumë pak komuna e kanë konfirmuar marrjen e mjetit. Shumica e komunave nuk e ka respektuar afatin e kërkuar. Një numër sosh, kanë pasur probleme me ndërrimin e personave kontaktues të Rrjetit për politika të gjuhëve, për faktin se pas zgjedhjeve lokale janë bërë ndryshime në udhëheqjet komunale. Vetëm një numër i vogël i komunave i është përgjigjur obligimit pas një muaji, prandaj ZKGJ-ja ka dërguar shkresë përsëri dhe janë lutur të gjitha komunat që nuk e kanë kryer obligimin dhe nuk i kanë dërguar informacionet, ta plotësojnë pyetësonin dhe ta dërgojnë më së largu deri në fund të vitit 2017. Edhe përkundër kësaj, mjeti nuk është dërguar. Sipas planifikimeve, raporti lidhur me këtë bëhet në çdo fillim vit.

Komisioni për monitorimin e subvencioneve dhe transfereve

Në cilësinë e anëtarit të Komisionit për monitorimin e subvencioneve dhe transfereve që ndahen nga Zyra për çështje të komuniteteve (Vendimi i Sekretarit të përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit i datës 05.06.2017, ref: 094/20170), ZKGJ-ja ka përfaqësuesin e vet i cili ka dhënë kontribut në të gjitha takimet që komisioni ka mbajtur gjatë vitit 2017. Janë kontrolluar raportet e përfituesve të subvencioneve, disa raporte të ZÇK/ZKM-së, lista e përfituesve të subvencioneve dhe pagesat e kryera nga Zyra e financave.

Hartimi i librave për mësimin e gjuhëve zyrtare për zyrtarët komunal

Në bashkëpunim me Qendrën Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI Kosova) dhe me financimin e Komisionerit të lartë për çështje të pakicave kombëtare, ZKGJ ka identifikuar dhe kontraktuar autorët për të hartuar nivelin A1, A2, dhe B1 të librave për mësimin e gjuhëve zyrtare (shqipe dhe serbe) për zyrtarët komunal në Kosovë. Këta libra do të përcillen edhe me ushtrimore si dhe manuale për mësimdhënësit. ZKGJ tashmë ka aprovuar konceptin e parë të përmbajtjes së librave të cilat pritet të finalizohen gjatë vitit 2018.

Kurset e gjuhëve zyrtare në komuna

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të nëpunësve civilë në komuna dhe përmirësimit të ofrimit të shërbimeve në gjuhët zyrtare për qytetarët, ZKGJ në bashkëpunim me ECMI dhe me financim të Komisionerit të lartë për çështje të pakicave kombëtare ka zhvilluar kurse të gjuhës shqipe dhe serbe. Kursi ka zgjatuar dy muaj, gjithsej 17 orë mësimore për secilën prej gjuhëve, ndërsa është zhvilluar në 7 komuna të Kosovës. Numri i kurseve të zhvilluara në këto komuna është dymbëdhjetë (12), 6 për gjuhën shqipe dhe 6 për gjuhën serbe. Tabela në vijim ofron të dhëna të detajuara të pjesëmarrjes në secilën komunë:




Figura 1. Pjesëmarrja e zyrtarëve në mësim të gjuhëve zyrtare
Slika 1. Učesće službenika na kursevima učenja službenih jezika

Të regjistruar në këto kurse ishin gjithsej 118 nëpunës civilë, 47 prej tyre kanë ndjekur kursin e gjuhës shqipe ndërsa 71 atë të gjuhës serbe.

Si rezultat janë certifikuar 40 pjesëmarrës në kursin e gjuhës shqipe, ndërsa 55 pjesëmarrës në kursin e gjuhës serbe, 23 pjesëmarrës të tjerë kanë marrë vetëm certifikatë për pjesëmarrje.

Trajnimi i trajnerëve të Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP)

Pas lansimit të Udhërrëfyesit për nëpunësit civilë për zbatimin e të drejtave gjuhësore, Zyra e Komisionerit për gjuhët, me përkrahje financiare të Misionit të OSBE-së, ka mbajtur trajnim për trajnerët e Institutit të Kosovës për Administratë Publike për përfshirjen e Udhërrëfyesit për zbatimin e të drejtave gjuhësore për nëpunësit civilë, si nën-modul në modulet e trajnimeve të IKAP-it. Në këtë trajnim është diskutuar për gjendjen aktuale lidhur me zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve në institucionet e nivelit qendror dhe të atij lokal në Kosovë, çështjet e ngritura në Zyrën e Komisionerit për gjuhët lidhur me shkeljen e Ligjit në institucionet e administratës publike si dhe përmbajtjen e udhërrëfyesit.

Gjithashtu, në këtë trajnim është angazhuar edhe një ekspert në fushën e të drejtave gjuhësore nga Kanadaja, ku pjesëmarrësve u është prezantuar një përmbledhje e origjinës së politikave gjuhësore në Kanada si dhe mundësitë dhe kufizimet e krahasimit të politikave gjuhësore përmes juridiksioneve të Kosovës dhe Kanadasë.

Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës

Me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve në gjuhët zyrtare nga Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Policinë e Uellsit Verior, ZKGJ ka realizuar një trajnim në lidhje me shërbimet dygjuhësore dhe praktikatat e policisë së Uellsit, për përfaqësuesit e lartë të Policisë së Kosovës. Bashkëpunimi i mëtejshëm në këtë fushë, pas trajnimit të realizuar, duhet të thellohet përmes zhvillimit të një manuali dygjuhësor për të siguruar njohuri profesionale të gjuhëve zyrtare në komunikimin bazë të pjesëtarëve të PK-së.

Bashkëpunimi me Drejtoratin e përgjithshëm për përkthime (DGT) të Komisionit Evropian

Qeveria e Kosovës ka shqyrtuar rekomandimet e Zyrës së Komisionerit për gjuhët dhe organizatave ndërkombëtare si OSBE, Këshilli i Evropës dhe Komisioni Evropian në lidhje me cilësinë e përkthimeve të dokumenteve zyrtare. Si rrjedhojë, më 03.11.2017 Qeveria e Kosovës ka nxjerrë Vendim për themelimin e Komisionit për analizimin e nevojës për formimin e njësisë për përkthime. Me qëllim të mbështetjes profesionale dhe marrjes së praktikave më të mira për këtë proces, në bashkëpunim me akterët kryesorë, ZKGJ-ja ka realizuar një vizitë studimore në Drejtorinë e përgjithshëm për përkthime në KE, në Bruksel. Gjatë kësaj vizite janë diskutuar praktikatat e përkthimit në DGT, menaxhimi i kualitetit të përkthimeve të brendshme dhe të jashtme, procedurat e rekrutimit, mjetet e teknologjisë informative dhe zhvillimi i data bazave të terminologjisë.

HETIMI DHE NDËRMJETËSIMI


HETIMI DHE NDËRMJETËSIMI

Veprimet të cilat ndërmerren nga Zyra, pas marrjes së ankesës

Duke u bazuar në kushtet e pranueshmërisë, verifikohet nëse ankesa është nën juridiksionin e Zyrës ose jo, pastaj vazhdohet me procedurën e zgjidhjes së saj. Parashtruesi i ankesës informohet me kohë për pranimin e ankesës dhe njoftohet nëse ankesa në fjalë bie nën juridiksionin e ZKGGJ-së.

Fillimisht bëhet konsultimi i legjislacionit, rregulloreve, udhëzimeve administrative si dhe të gjitha fakteve dhe dëshmive të mbledhura të cilat janë relevante për analizën ligjore.


Zyra në secilën fazë të shqyrtimit të ankesave ofron shërbimet e saj të mirëbesimit, ndërmjetësimit ose pajtimit. Në rast se arrihet ndonjë marrëveshje miqësore ndërmjet palëve, Zyra ndërpret shqyrtimin e rastit dhe e mbyll atë pas përmbushjes së detyrimeve të marrëveshjes së arritur.



Procedura hetimore, pas vendosjes së Komisionerit për gjuhët që të zhvillohen hetimet


Gjatë fazës së hetimit, Zyra mund të intervistojë dëshmitarë ose persona të tjerë si dhe të kërkojë nga institucionet nën juridiksionin e saj qasje në informatat relevante, dosje dhe dokumente (me përjashtim të dokumenteve të klasifikuara), që i kontribuojnë zgjidhjes së rastit.

Në rast të mos përmbushjes së rekomandimeve dhe refuzimit të shqyrtimit të ankesave nga cilido institucion nën juridiksionin e Zyrës dhe mos marrjen parasysh të këshillave dhe kërkesave që bëhen lidhur me respektimin e të drejtave gjuhësore, Zyra mund të iniciojë fillimin e masave disiplinore, lëshojë vërejtje për mos përmbushjen e rekomandimeve dhe të merr vendime për ndëshkime.



Aplikacioni “Language Officer”

Me qëllim të lehtësimit të parashtrimit të ankesave, përmes të cilave adresohen shkeljet e të drejtave gjuhësore nga qytetarët, është përgatitur aplikacioni ‘Language Officer’ për telefonat e mençur. Për këtë aplikacion Zyra është mbështetur nga USAID-i përmes projektit: “Avancojmë Kosovën në Bashku” të cilin e ka zbatuar OJQ-ja Komunikim për zhvillim të shoqërisë (CSD) nga Graçanica. Ky program softuerik funksionon në të dy platformat dhe është i përshtatshëm si për Android ashtu edhe për IOS sistemet operative. Aplikacioni funksionon në mënyrë shumë të thjeshtë, është e mjaftueshme që përdoruesi ta marrë nga Apple Store apo Google Play store, të instaloj atë në telefonin e vet mobil dhe përmes tij të dërgoj fotot për të gjitha pretendimet për shkelje të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.



Aplikacioni / Aplikacija Language Officer

Ankesat e pranuar gjatë vitit 2017

Zyra e Komisionerit për gjuhët këtë vit ka pranuar dyzet e dy (42) ankesa. Prej tyre janë zgjidhur tridhjetë e dy (32), ndërsa dhjetë (10) janë në proces. Gjatë kësaj periudhe janë zgjidhur/mbyllur dymbëdhjetë (12) ankesa të vitit 2016, një (1) ankesë e vitit 2015 dhe një (1) ankesë e vitit 2014.

Lidhur me pretendimet për shkelje të Ligjit nga institucionet, në Zyrën e Komisionerit për gjuhët janë adresuar ankesa nga qytetarët përmes postës elektronike, postës rekomande, përmes debateve me publikun si dhe përmes aplikacionit 'Language officer'. Për çështjet e ngritura janë ndërmarrë një sërë veprimesh dhe janë lëshuar rekomandimet e nevojshme për institucionet nën juridiksionin e Zyrës.



Figura 2. Numri i ankesave të pranuar krahasuar me vitet paraprake
Slika 2. Broj primljenih žalbi u poređenju sa prethodnim godinama

Shqyrtimi i ankesave

Zyra e Komisionerit për gjuhët, bazuar në mandatin e saj edhe gjatë këtij viti ka vazhduar me shqyrtimin e ankesave të pranuar. Çështjet e adresuara nga qytetarët lidhur me dështimin e institucioneve për respektimin e të drejtave gjuhësore kanë të bëjnë me mungesën e njërës nga gjuhët zyrtare në ueb faqet elektronike zyrtare të institucioneve, mungesën e përkthimit në takimet dhe konferencat e mbajtura, si dhe mungesën e informatave në gjuhët zyrtare në ueb faqet zyrtare, me theks të veçantë në ftesat dhe komunikatat për medie, mungesa e njërës nga gjuhët zyrtare te përshkrimi i gjobave për kundërvajtje të lëshuara nga Policia e Kosovës, mungesa e gjuhëve zyrtare në fletë udhëzuesit e barërave, mungesa e njërës nga gjuhët zyrtare në vendimet e lëshuara nga gjykatat, mungesa e gjuhëve zyrtare në testet e organizuara me rastin e aplikimit për punë si dhe mungesa e gjuhëve zyrtare në administratën e Universitetit. Ankesa janë parashtruar edhe nga zyrtarët drejtuar institucioneve me rastin e dërgimit të shkresave dhe vendimeve vetëm në njërën gjuhë zyrtare në komunikimet ndër-institucionale. Janë bërë vizita në institucionet përkatëse për të diskutuar për gjetjen e zgjidhjes së ankesave të parashtruara. Në disa raste është ndihmuar institucioni përkatës në përmirësimin e shërbimeve gjuhësore përmes lektorëve dhe përkthyesve për gjuhën shqipe dhe serbe, të angazhuar nga ZKGJ.

Niveli i gatishmërisë së institucioneve të lartcekura ka rënë krahasuar me vitet paraprake, pasi që zbatimin e rekomandimeve të lëshuara nga Zyra si dhe adresimi i çështjeve të ngritura nga qytetarët nuk janë marrë me prioritet. Është vërejtur një neglizhencë e institucioneve lidhur me respektimin e të drejtave gjuhësore. Shqetësim për zbatimin e të drejtave gjuhësore paraqet përsëritja e rasteve të njëjta për institucionet e njëjta, kur njëherë është zgjidhur çështja dhe është konsideruar e rregulluar dhe nuk ka qenë e pritshme që të përsëriten lëshimet e njëjta.




Figura 3. Numri i ankesave të marra
Slika 3. Broj primljenih žalbi




Figura 4. Numri i ankesave të pranuar sipas përkatësisë së komuniteteve
Slika 4. Broj primljenih žalbi prema pripadnosti zajednici




Figura 5. Numri i ankesave të referuara në institucione qendrore dhe lokale.
Slika 5. Broj primljenih žalbi koji se odnose na centralne i lokalne institucije

- Mosofrimi i testit në gjuhën turke/Nepostojanje testova na turskom jeziku
- Mungesa e gjuhës serbe në dokumentet e ueb faqeve të institucioneve qendrore dhe komunale/Neobjavlivanje srpske verzije dokumenata na zvaničnim internet stranicama institucija
- Mungesa e gjuhës shqipe dhe serbe në fletëudhëzuesit e barërave/Uputstva za upotrebu lekova ne sadrže prevod na albanski i srpski jezik
- Mungesa e informatave në gjuhën serbe në njoftimet në sportelet e komunës/Nedostatak informacija na srpskom jeziku u obaveštenjima na šalterima opštine
- Mungesa e gjuhës shqipe dhe serbe në raporte mjekësore/Nepostojanje albanskog i srpskog jezika u lekarskim izveštajima
- Mungesa e gjuhës serbe në komunikatat për medie/Komunikacija sa medijima se ne obavlja/odvija na srpskom jeziku
- Mungesa e gjuhës serbe në dokumentet e kadastrit në zyrat komunale/Nepostojanje katastarskih dokumenata opštinskih kancelarija na srpskom jeziku
- Mungesa e gjuhës serbe në gjykata: Formularë, Vendime/Nepostojanje sudskih dokumenata: formulara, presuda na srpskom jeziku
- Mungesa e gjuhës serbe në mbishkrimet dhe sportelet e informimit në KEDS/Nedostatak informacija na srpskom jeziku na šalterima KEDS
- Mungesa e gjuhës serbe në mbishkrimin e gjobës së lëshuar nga Policia e Kosovës/Kazna koju je izdala Policija Kosova napisana je samo na albanskom jeziku
- Mungesa e gjuhës serbe në dokumentet të cilat dërgohen nga institucionet qendrore/Centralne institucije ne šalju dokumenta na srpskom jeziku
- Mungesa e gjuhës serbe në kontratat e bankave/Nepostojanje srpskog jezika u bankarskim ugovorima
- Mungesa e gjuhës serbe në dokumentet e Univerzitetit të Prizrenit/Nepostojanje srpskog jezika u dokumentima na Univerzitetu u Prizrenu




Figura 6. Numri i ankesave të marra dhe çështjet e adresuara.
Slika 6. Priljene žalbe prema vrsti prijave

Disa nga çështjet e parashtruara

• Ueb faqet zyrtare të institucioneve

Mungesa e gjuhëve në ueb faqet elektronike zyrtare të institucioneve qendrore vazhdon të adresohet nga qytetarët, ku ka raste kur edhe legjislacioni i cili është i gatshëm dhe i përkthyer në gjuhët zyrtare nuk është në dispozicion në versionin në gjuhën serbe. Në vitin 2013 është përgatitur Raporti mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare në ueb faqet e Institucioneve Qendrore të Republikës së Kosovës në bazë të cilit janë nxjerrë edhe rekomandimet dhe i njëjti është dërguar te sekretarët e përgjithshëm të institucioneve përkatëse. Ngecja në zbatimin e rekomandimeve ka bërë që të ngritet edhe njëherë kjo çështje, ku edhe këtë vit janë përgatitur dhe dërguar rekomandimet e nevojshme.

Gjendja është përmirësuar në disa nga institucionet e monitoruara, dhe janë për t'u marrë si shembull: Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, përderisa shumica apo pjesa tjetër nuk kanë lëvizur në drejtim të përmirësimit.

▪ **Komunikimi me media**

Në një numër të konsiderueshëm të ankesave të parashtruara në ZKGJ lidhur me përdorimin e gjuhëve zyrtare është theksuar dërgimi i ftesave dhe komunikatave për medie. Kjo çështje është adresuar në diskutimet me publikun, përmes telefonit si dhe përmes ankesave të shkruara. Bazuar në ankesat e marra është vendosur të bëhet monitorimi i institucioneve përkatëse. Parashtruesit e ankesave në këtë rast gazetarët ankohen për mungesën e gjuhëve zyrtare (në shumicën e rasteve për gjuhën serbe) në konferencat për gazetarë si dhe në mbledhjet e organizuara të cilat janë të hapura për medie.

Gjendja është përmirësuar në disa nga institucionet e monitoruara, dhe janë për t'u marrë si shembull: Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, përderisa shumica apo pjesa tjetër nuk kanë lëvizur në drejtim të përmirësimit.

▪ **Komunikimi ndërinstytucional**

Zyrtarë nga institucionet (kryesisht institucionet lokale drejtuar institucioneve qendrore), dërgojnë në vazhdimësi ankesa për mungesën e gjuhëve zyrtare në komunikimet ndërinstytucionale kur një vendim, ftesë, shkresë zyrtare dhe korrespondencat të tjera institucionale dërgohet vetëm në njërin nga gjuhët zyrtare.

Pas marrjes së ankesave me ndërmjetësimin e Zyrës çështjet e adresuara janë zgjidhur në pothuajse shumicën e rasteve. Sidoqoftë praktika e njëjtë e komunikimit ndërinstytucional ku është evidente mungesa e njëres nga gjuhët zyrtare po vazhdon.

▪ **Përdorimi i gjuhëve në fletë udhëzimet e barërave**

Çështja e përdorimit të gjuhëve zyrtare në fletë udhëzimet dhe përshkrimin e barërave si dhe produkteve të tjera medicinale të cilat ofrohen nga barnatoret në Kosovë është ngritur në vazhdimësi nga qytetarët pas hasjes së vështirësive kur një bar apo produkt i blerë ka qenë

vetëm në gjuhën turke, italiane ose ka qenë në dispozicion vetëm në njërën nga gjuhët zyrtare. Pas takimit të mbajtur me ud. kryeinspektorin e Inspektoratit Farmaceutik kemi pranuar raportin në të cilin janë paraqitur të gjitha rastet e hapura për mospërdorimin e gjuhëve zyrtare në produktet e lartcekura, ku janë përfshirë edhe rastet e adresuara në Zyrën e Komisionerit për gjuhët. Vlen të theksohet që korniza ligjore lidhur me përdorimin e gjuhëve zyrtare në pajisjet dhe produktet medicinale është në përputhje të plotë me Ligjin Nr.02/L-37 për përdorimin e gjuhëve.

INFORMIMI DHE DUKSHMËRIA

INFORMIMI DHE DUKSHMËRIA

Vetëdijesimi i institucioneve dhe qytetarëve për zbatimin e Ligjit

Zyra në vazhdimësi ka bërë vetëdijesimin e opinionit dhe institucioneve publike mbi të drejtat dhe obligimet gjuhësore, si dhe rolin e Zyrës në mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e të drejtave gjuhësore.

Komunikimi është bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë, me qytetarët dhe përfaqësuesit e institucioneve, në takime, tryeza të rrumbullakëta, biseda si dhe debate të ndryshme.

Në kuadër të sensibilizimit të vazhdueshëm të shoqërisë, ZKGJ, në bashkëpunim me Grupin punues për çështje të gjuhëve, në Këshillin Konsultativ për Komunitete/Zyra e Presidentit, ka organizuar pesë (5) tryeza të rrumbullakëta me temën “Qasja e mediave lokale dhe e shoqërisë civile në përdorimin dhe promovimin e gjuhëve zyrtare në komunë”, të cilat janë mbajtur në: Graçanicë, Kamenicë, Pejë/Vitomiricë, Dragash dhe Zveçan. Si veçanti e këtyre debateve është se për herë të parë ZKGJ ka organizuar debat në pjesën veriore të Kosovës.

Në këto debate është biseduar kryesisht për gjetjen e modaliteteve të ndryshme në qasjen e mediave lokale dhe shoqërisë civile në përdorimin dhe promovimin e gjuhëve zyrtare. Përpos mediave lokale dhe shoqërisë civile në debate kanë marrë pjesë përfaqësues të zyrës së Avokatit të popullit, përfaqësues të MAPL-së si dhe zyrtarë komunal për çështje të komuniteteve.

Gjatë këtyre pesë (5) debateve, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe mediat lokale kanë identifikuar një numër të konsiderueshëm të parregullsive në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve të cilat paraqesin vështirësi në marrjen e shërbimeve të ndryshme në komuna, agjenci shtetërore apo ndërmarrje publike:

- Numri i pamjaftueshëm i zyrtarëve që flasin një gjuhë tjetër zyrtare ose një gjuhë në përdorim zyrtar në institucione lokale
- Disa nga dokumentet e ndryshme zyrtare për qytetarë janë vetëm në një gjuhë;
- Faqet zyrtare të internetit nuk janë të përditësuara. Mungojnë informacionet e ndryshme e sidomos lajmet e ngjarjet që nuk janë të përkthyer në gjuhën serbe e që krijojnë probleme në marrjen e shpejtë të informacioneve nga ana e gazetarëve.

Duke u bazuar në një pjesëmarrje të konsiderueshme të rreth njëqind e njëzetë (120) pjesëmarrësve, tryezat e mbajtura kanë pasur një efekt të konsiderueshëm, gjithmonë me synim të rritjes së ndërgjegjësimit mbi të drejtat gjuhësore të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Republikën e Kosovës.

Ftesa për propozime të projekteve

Zyra e Komisionerit për gjuhët, më 25 tetor ka bërë ftesën për propozime, për aplikim për grante nga Organizatat joqeveritare, si mbështetje për Zyrën e Komisionerit për gjuhët (ZKGJ) në zbatimin e misionit të saj, për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave gjuhësore, sipas kornizës ligjore nacionale të Republikës së Kosovës.

- Kërkesa e ZKGJ-së për të bërë Ftesë për propozime, u aprovua nga Kabineti i Kryeministrit më 12.10.2017;
- Ftesa u bë më 25 tetor deri më 8 nëntor 2017, përmes mediave dhe në ueb faqen zyrtare të ZKGJ-së;
- Thirrja publike për anëtarë të jashtëm të komisionit është bërë më 22.11.2017, pas konsultimeve të Rregullores së MF- Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve;
- Pas përzgjedhjes së dy anëtarëve të komisionit nga shoqëria civile, Sekretari i Përgjithshëm, ka marrë vendimin për emërimin edhe të tre anëtarëve të tjerë të ZKGJ/ZKM.
- Kësaj ftese i janë përgjigjur OJQ-të e të gjitha komuniteteve në Kosovë, të cilat në projekte kanë përfshirë çështjet rreth gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve në përdorim zyrtar në Republikën e Kosovës. Janë gjithsej 9 projekt-propozime, të cilat synojnë të ndihmojnë Zyrën në përmbushje të mandatit të saj.

Komisioni u takua më 27.11.2017 dhe shqyrtoi të gjitha aplikacionet një nga një, vlerësoi se projektet kanë një përfshirje territoriale të mirë, ka projekte nga të gjitha komunitetet, kështu që përveç rëndësisë së zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, i kushtohet vëmendje edhe promovimit të gjuhëve dhe vetë ZKGJ-së. Komisioni si qëndrim të përbashkët mori:

- Të stimulohen të gjitha projektet, meqenëse është një numër i vogël i aplikacioneve, prandaj komisioni konsideroi se të gjitha këto projekte mund të mbulohen financiarisht dhe mund të arrijnë objektivat e parapara, me disa specifika të ndryshuara, pas konsultimeve me ZKGJ-në;
- ZKGJ do të bëjë konsultime me secilin veç e veç, për të diskutuar fillimisht rreth buxhetit të kërkuar, por edhe për aktivitetet të cilat mendohet se duhet të jenë më prioritare që të zbatohen në praktikë;
- Mjetet financiare të kërkuara nga OJQ-të të diskutohen në detaje, për të sqaruar arsyeshmërinë;
- Mjetet e kërkuara nga OJQ-të për koordinatorët e projekteve të jenë maksimalisht 200 euro;
- Përkrahja financiare të ndahet edhe në bazë të poentimit, respektivisht vlerësimit të përgjithshëm të komisionit (në qoftë se nuk ka arsyeshmëri të mjaftueshme për planifikimin buxhetor);
- Për këtë të njoftohen të gjitha OJQ-të me kohë, të qartësohen kërkesat e ZKGJ-së dhe para se të nënshkruhet Marrëveshja e bashkëpunimit, të definohen qartë veprimet dhe kostoja e mëtutjeshme;
- ZKGJ të kërkojë formë të re buxhetore(të rregulluar) pasi të jetë konsultuar me përfaqësuesit e OJQ-ve dhe pastaj të bëjë marrëveshjen dhe ndarjen e mjeteve;
- Të përpilojë raportin i cili do të nënshkruhet nga anëtarët e komisionit.

Bazuar në të gjitha pikat e diskutuara, komisioni ka bërë vlerësimin:

- OJQ "Roma in Action" - Komisioni u dakordua që të mbështeten vetëm qëllimet të cilat kanë të bëjnë me gjuhën rome, në bazë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.
- OJQ "Prijetelstvo" - Buxheti i kërkuar, tejkalon pritshmërinë e projekt -propozimit.
- OJQ "CSD"- Buxheti tejkalon të priturat nga aktivitetet, është shumë i madh (të reduktohet).
- OJQ "STARS" - Të zbatohet projekti për gjashtë muaj, e jo për katër siç është planifikuar në projekt, për shkak të aktiviteteve të cilat nuk mund të zbatohen brenda katër muajve. Të zvogëlohen aktivitetet e panevojshme dhe të fokusohet në kurs të gjuhëve.
- OJQ "Proaktive" - Të zvogëlohet buxheti, numri i debateve dhe aktiviteteve. Të punohet në emisionet televizive, por me një numër më të vogël, për të arritur kualitet. Në emisione të jetë prezente ZKGJ-ja.

Pas vlerësimit të bërë prej secilit anëtarë të komisionit, pikët e përbashkëta kanë renditur projektet si më poshtë:

	OJQ	POENAT	SHUMA E KËRKUAR	SHUMA E NDARË	VËREJTJE
1.	CSI	82.6	7.870	7.300	Është kërkuar raportim i rregullt financiar dhe për aktivitetet.
2.	CSD	74.4	9.877.5	7.950	-//-
3.	STARS	72.8	5.780	5.250	-//-
4.	AKTIV	68.4	9.520	6.950	-//-
5.	VKBIK	68.0	8.200	5.950	-//-
6.	CDKD	64.2	7.990	5.200	-//-
7.	PRIJATELJSTVO	63.4	9.850	5.100	-//-
8.	PROAKTIVE	55.4	9.999	4.400	-//-
9.	ROMA IN ACTION	51.8	9.680	1.700	-//-

Raporti iu dërgua anëtarëve të Komisionit për nënshkrim. Pas nënshkrimit të raportit, është përgatitur Marrëveshja e bashkëpunimit për secilin projekt dhe janë nënshkruar nga të dy palët, Zyrës së Komisionerit për gjuhët dhe përfaqësuesve të OJQ-ve. Mjetet financiare janë ndarë sipas marrëveshjes dhe aktivitetet kanë filluar menjëherë.

Shënimi i Ditës Evropiane të Gjuhëve

Viti Evropian i Gjuhëve është shpallur më 2011. Është organizuar bashkërisht nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian, dhe meqë është treguar si një vit i sukseshëm dhe ka përfshirë miliona njerëz nga 45 vendet pjesëmarrëse, Këshilli i Evropës ka deklaruar që 26 shtatori të jetë Dita Evropiane e Gjuhëve.

Për herë të katërt, më 26 shtator 2017, ZKGJ ka shënuar Ditën Evropiane të Gjuhëve, duke marrë pjesë aktivisht dhe duke bërë fushatë në komunat Prizren, Gjilan, Obiliç dhe Mitrovicë.

Prizren - Zyra e Komisionerit për gjuhët në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Misioni në Kosovë, kanë organizuar takim të përbashkët me studentët dhe profesorët e Universitetit të Prizrenit, organizata Jo-Qeveritare dhe me zyrtarë komunalë.

Mitrovicë - Është organizuar një aktivitet lidhur me promovimin e kësaj dite në qendër të Mitrovicës. Përfaqësuesit ZKGJ-së përmes këtij aktiviteti kanë bashkëbiseduar më shumë qytetarë për t'i informuar ata për të drejtat e tyre gjuhësore, njëkohësisht për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe institucioneve lidhur me të drejtat gjuhësore, për të mbështetur zbatimin efektiv të Ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare.

Obiliq - Plemetinë - Zyra së bashku me OSBE, Misioni në Kosovë, kanë takuar nxënësit e klasave të përziera të të dy shkollave, ku me ta është biseduar për rëndësinë e shënimit të Ditës Evropiane të Gjuhëve.

Gjilan- ZKGJ ka marrë pjesë në një tryezë të rrumbullakët ku ka takuar zyrtarë komunalë të rajonit të Gjilanit, qytetarë dhe përfaqësues të Organizatava Jo-Qeveritare. Përfaqësuesit e ZKGJ-së, kanë folur para një audience të gjerë për rëndësinë e njohjes së sa më shumë gjuhëve evropiane por me theks të veçantë edhe për respektimin dhe të drejtat e gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovë.

Në të gjitha këto ngjarje janë shpërndarë materiale promovuese.

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Rome, ZKGJ ka ftuar të gjithë qytetarët që të përdorin, ruajnë dhe kultivojnë gjuhën rome, ta konsiderojnë ZKGJ-në si partner bashkëpunues. Çdo vit më 5 nëntor, romët në Evropë festojnë këtë ditë. E folur në të gjithë botën, gjuha rome është një gjuhë e ruajtur dhe e bartur nga brezi në brez gjatë shekujve, kryesisht në formën e të folurit.

Debate me qytetarë dhe institucione

Kamenicë - Përfaqësuesit e ZKGJ-së morën pjesë në debat me qytetarë të Kamenicës, të organizuar nga Organizata Jo-Qeveritare Komunikimi për Zhvillimin Shoqëror (CSD) dhe Organizata Jo-Qeveritare "Omonia". Në këtë takim, përfaqësuesit e ZKGJ-së patën rastin të diskutojnë mbi zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, procesin e monitorimit të institucioneve, procedurat dhe mënyrat e ankimit si dhe mënyrat e ndryshme të senzibilizimit të shoqërisë mbi të drejtat gjuhësore.

Prizren - Përfaqësuesit e ZKGJ-së morën pjesë në takimin me temën: "Ndërlidhja e pushtetit lokal dhe mediave në regjionin e Prizrenit", me qëllim të promovimit dhe përmirësimit të komunikimit ndërmjet mediave dhe institucioneve komunale, në përmirësim të vazhdueshëm të administratës publike - më transparente dhe llogaridhënëse, si dhe më afër qytetarit në respektimin e aspektit gjuhësor.

Paraqitjet mediale

Gjatë vitit 2017, Zyra ka pasur paraqitje të konsiderueshme mediale: në programin e mëngjesit të RTK2, në programin "Express" në Televizionin Koha Vision, në kanalin RTK3, Radio Kosova 2, (transmetim në 5 gjuhë), në radiot lokale KIM, TV Puls, Radio Peja, Radio Gorazhdevac, Radio Sharri, Radio Graçanicë, Kosovo24sata, newpressproduction, gracanicaonline.info, Kossev, Radio Televizioni Mir, Radio Televizioni Most, në gazetën e përditshme Koha Ditore, në gazetën e përditshme Zëri, Anadolu Agency, Kosova Press.

Faqja zyrtare e internetit

Faqja zyrtare e internetit në vazhdimësi rifreskohet me lajme dhe ngjarje, publikime, raporte dhe intervista të ndryshme, që janë transmetuar përmes mediave elektronike, duke qenë në dispozicion në pesë (5) gjuhë (shqipe, serbe, boshnjake, turke dhe angleze). Gjithsej, në faqen zyrtare të Zyrës, janë vendosur 32 lajme dhe ngjarje.

Bashkëpunimi me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë

ZKGJ përmes projekteve ka vazhduar bashkëpunimin me organizatat vendore dhe ndërkombëtare, siç janë: Ambasada Zvicerane, OSBE, USAID, EUSR, ECMI, CSD.

Përpos projekteve të përbashkëta me organizatat e lartcekura, janë mbajtur edhe takime të ndryshme me interes për ZKGJ-në:

- Në Forumin e nivelit të lartë për respektimin e të drejtave gjuhësore, me temën "Respektimi i të drejtave gjuhësore në Kosovë" organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, ka marrë pjesë komisioneri Mladenovic. Ky forum kishte për qëllim të shërbejë si platformë për përfaqësuesit e shteteve që zbatojnë dy gjuhësinë, të ndajnë përvojat e tyre lidhur me të drejtat gjuhësore. Në prezantimin e tij, komisioneri Slavisa Mladenovic ka theksuar se ka mangësi në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe kjo është më se e evidente në përdorimin e drejtshkrimit dhe gramatikën e gjuhëve zyrtare në Kosovë. Kjo është sfidë të cilën Zyra në vazhdimësi bënë përpjekje në tejkalimin e sajë përmes projekteve të ndryshme drejt zbatimit të plotë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.
- Konferenca vjetore e Asociacionit Ndërkombëtar të Komisionerëve të gjuhëve, këtë vit është mbajtur në muajin maj, në qytetin Cardiff, Uels, Mbretëria e Bashkuar. Tema kryesore e kësaj konference ishte: "Rëndësia e teknologjisë dhe planifikimit strategjik për krijimin e dygjuhësisë në vende të punës", me theks të veçantë në zhvillimin e fuqisë punëtore në mënyrë që të ofrojë shërbime për qytetarët në gjuhën e zgjedhur nga ana e tyre. Është diskutuar rreth gjetjes së mënyrave specifike në mjetet dhe zgjidhjet praktike të cilat mund të lehtësojnë qasjen ndaj qytetarëve, si dhe mënyrat inovative përmes teknologjisë informative në punë. Gjithashtu, gjatë debateve të shumta në konferencë janë shkëmbyer përvojat dhe njohuritë e praktikave të mira.

Për funksionimin më të mirë të Zyrës dhe përmbushjen e objektivave të saj, ofrohet mbështetje nga institucionet ndërkombëtare, përmes takimeve të ndryshme në të cilat diskutohet tejkalimi i vështirësive, deri te mbështetja financiare.

- Nga shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë dhe Përfaqësuese e Posaçme e BE-së, Nataliya Apostolova, është ofruar mbështetje drejt avancimit dhe respektimit të të drejtave gjuhësore si dhe ofrimit të shërbimit sa më të mirë të qytetarëve në gjuhët zyrtare, përmes resurseve që Zyra e BE-së në Kosovë i posedon.
- Ambasadori Lamberto Zannier, Komisioner i lartë i OSBE-së për pakicat kombëtare, po ashtu ka treguar interesim të veçantë për fushën e respektimit të të drejtave të njeriut, përfshirë respektimin e të drejtave gjuhësore. Ambasadori Zannier ka potencuar se të drejtat gjuhësore dhe mbrojtja e pakicave është shumë e rëndësishme në kultivimin e tolerancës dhe mosdiskriminimit, si pikë kyçe në demokracitë e zhvilluara.
- Mangësitë dhe kualiteti i dobët i versioneve zyrtare i ligjeve të cilat më pas reflektohen në punën e gjykatave dhe insitucioneve në përgjithësi, është trajtuar jo vetëm nga institucionet relevante vendore, por edhe në takim me ambasadorin e Kanadasë në Kroaci (jo resident për Kosovën), Daniel Maksymiuk dhe znj.Laurie Wright, asistente e zëvendës ministrit të Ministrisë së Drejtësisë në Kanadë. Ambasadori Daniel Maksymiuk u shpreh i gatshëm në intensifikimin e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Kanadasë në fushën e gjuhëve dhe mbështetjen e dygjuhësisë në Kosovë. Komisioneri Mladenovic e vlerësoi lart forcimin e bashkëpunimit dhe theksoi rëndësinë e thellimit të këtij bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve në fushën e gjuhëve, duke marrë praktikrat më të mira nga Kanada.



Në ceremoninë përmbyllëse të programimit trevjeçar Avancojmë Kosovën së Bashku (AKT)-USAID, Zyrës së Komisionerit për gjuhët i është dhënë certifikata për bashkëpunim të mirëfilltë në disa projekte me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Zyra e Komisionerit për gjuhët nëpërmjet programit AKT, ka zbatuar projektin “Mbështetje përpjekjeve të Komisionerit

për gjuhët për të promovuar përdorimin e gjuhëve zyrtare në 12 komuna partnere të programit të USAID-it” të Avancojmë Kosovën së Bashku në: Graçanicë, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Gjilan, Partesh, Kllokot, Shtërpce, Klinë, Pejë, Istog dhe Vushtrri.

- Konferenca Rajonale për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut dhe të Komuniteteve jo shumicë, e organizuar nga Këshilli Konsultativ për Komunitete, i cili funksionon në kuadër të Zyrës së Presidentit, ka ofruar mundësinë që të trajtohen shumë çështje. Në këtë konferencë ka marrë pjesë edhe komisioneri Mladenovic, me ç’rast ka diskutuar për situatën e përgjithshme të respektimit të të drejtave gjuhësore në tërë territorin e Kosovës.

Programi Apprenticeship (praktikës) i OSBE-së

Ky projekt është bërë pjesë e ZKGJ-së para dy vitesh. Në vitin 2017, zyra ka pranuar dhe ka përcjellë praktikën dhe ka ndihmuar një student për tre muaj. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur të gjitha aktivitetet përcjellëse të këtij projekti, përfshirë edhe konferencën finale, me ç'rast janë ndarë certifikata për studentët, por edhe menaxherët e projektit.

REKOMANDIMET

Zyra e Komisionerit për gjuhët, bazuar në monitorim dhe zgjidhje të ankesave, gjatë vitit 2017 ka dhënë 120 rekomandime.

Përmes platformës për konsultime publike, ZKGJ u ka dhënë rekomandime institucioneve të nivelit qendror për nëntëmbëdhjetë (19) akte ligjore të cilat i ka monitoruar përmes kësaj platforme:

- Të rregullohen gabime të konsideruara gjuhësore, gramatikore;
- Të evitohen përdorimi i shprehjeve dhe termeve në gjuhët e huaja, të cilat janë të pa qarta për gjuhët zyrtare në të cilat hartohen aktet normative;
- Të evitohen përdorimi i termeve dhe shprehjeve të ndryshme në gjuhën kroate dhe boshnjake, e që dallojnë nga termet në gjuhën serbe;
- Emërimi i Projekt-rregullores të mos përdoret ndryshe nga emri i Ligjit;
- Të evitohen mospërputhshmëri përmbajtjesore dhe kundërthënëse, të cilat shpesh dispozitën e aktit e bëjnë të pa qartë dhe krijojnë mundësi të interpretimit të dyfishtë;
- Gjuhët të koordinohen që të mos ketë mospërputhje dhe paqartësi gjuhësore.

Rekomandimet për ZKM-në:

- Të iniciohet procedura e korigjimit (plotësimit/ ndryshimit të Vendimit Nr.11/8 të Qeverisë së Kosovës, si dhe shtojcat e këtij vendimi;
- Të përcaktohet qartë emri i Republikës së Kosovës (versioni në gjuhën serbe) dhe të sigurohet barazia e gjuhëve zyrtare, në kuptim të llojit dhe madhësisë së shkronjave.
- Të përgatitet një shkresë qarkore dhe të shpërndalet në të gjitha institucionet publike, me udhëzime të qarta për zbatimin e Vendimit të ri.
- Të urdhërohet Ministria e Administratës Publike që të bëjë rregullimet gjuhësore në të gjitha mbishkrimet në institucionet e nivelit qendror dhe lokal.
- Ta obligohet Departamenti i Standardeve dhe Politikave të Inxhinierisë dhe Menaxhimit të ndërtesave qendrore (DSPIMN) që tabelat me emërtimet e institucioneve t'i vendosë ashtu si e parasheh Udhëzimi administrativ Nr.05/2009 për strukturën organizative të Ministrisë së Administratës Publike duke zbatuar edhe dispozitat e Kushtetutës dhe Ligjit për përdorimin e gjuhëve.
- Të zbatohet Vendimi i ri, në të gjitha aktet e reja dhe dokumentet zyrtare, përfshirë ligjet, dispozitat, urdhrat dhe të gjitha dokumentet zyrtare.
- Përdorimi i gjuhëve duhet të jetë i barabartë edhe në fonte dhe në dizajn.

MAP-in:

- Të përfundohet Katalogu i vendeve të punës në gjuhën serbe.
- Të rregullohet/n:
- Sistemi elektronik i organizatave joqeveritare;
- Udhëzimi administrativ për standardizimin e hartimit të akteve normative (përfshirë dokumentet përcjellëse);
- Shtojca për Rregulloren për përshkrimin e vendeve të punës;
- Formularët e Rregullores (MAP) Nr. 01/2015;
- Shtojca e Rregullores Nr. 02.2014;
- Formulari i vlerësimeve në punë;
- Formulari për udhëtime zyrtare;
- Kërkesat për shfrytëzimin e veturave zyrtare (dhe të gjithë formularët që kanë të bëjnë me vetura);
- Mbishkrimi në gjykata.

KQZ-në:

- Formularët të rregullohen në të dy gjuhët në të njëjtën faqe, në mënyrë që qytetari apo zyrtari t'iu shmanget pengesave që mund t'i hasë kur kërkon një formular të caktuar, në gjuhën shqipe apo serbe.
- Zyra do të ofrojë përkrahje në aspektin profesional, që njëherë e mirë këta formularë të rregullohen dhe të standardizohen. Ministria do ta kishte më lehtë kur ata t'i postojë në ueb faqe.
- Të gjithë ata formularë që janë vetëm në gjuhën shqipe, të përkthehen edhe në gjuhën serbe.

Rekomandimet e dhëna nga Zyra bazuar në ankesat a marra:

Për ministritë:

- Institucionet të marrin masat e nevojshme që të zbatojnë plotësisht Ligjin Nr.02/L-37 për përdorimin e gjuhëve për të rregulluar kështu çështjen e përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe realizimin e të drejtave gjuhësore.
- Duke marrë parasysh se gjuha shqipe dhe ajo serbe, si dhe alfabetet e tyre kanë status të barabartë si gjuhë zyrtare, personave fizikë ose juridikë të iu ofrohet mundësia që të gjitha të dhënat t'i kenë në dispozicion në gjuhët zyrtare.
- Komunikimi me media të bëhet në të njëjtën kohë në dy gjuhët zyrtare, duke respektuar statusin e barabartë të tyre.
- Komunikimi ndërinstytucional të bëhet duke respektuar statusin e barabartë të gjuhëve zyrtare dhe kjo praktikë të përfshihet nga të gjitha institucionet publike të nivelit qendror.

Komunën e Prizrenit – Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare:

- Të gjithë qytetarëve pa dallim t'iu ofrohen shërbimet në të gjitha gjuhët zyrtare të Komunës.

- Të merren masat e nevojshme që të zbatohet plotësisht Ligjin për përdorimin e gjuhëve në nivel lokal, për të rregulluar kështu çështjet e përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe realizimin e të drejtave gjuhësore.
- Të ofrohet dokumentacioni publik në gjuhët zyrtare shqipe, serbe, turke dhe boshnjake.
- Informacionet dhe udhëzimet të cilat janë publikuar në gjuhën shqipe, të publikohen në të njëjtën kohë në gjuhët tjera zyrtare.
- Konkursat dhe të gjitha shpalljet publike të publikohen në të gjitha gjuhët zyrtare dhe të mundësohet përkthimi për të gjithë qytetarët të cilët aplikojnë në institucionet komunale.

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2018

OBJEKTIVI

Ngritja e nivelit të zbatimit të Ligjit Nr.02/L-37 për përdorimin e gjuhëve.

Aktivitetet:

1. Inicimi për themelimin dhe funksionalizimin e Byrosë shtetërore për përkthime (miratimi i dokumenteve dhe i vendimeve përcjellëse).
2. Blerja e programeve elektronike (softuerëve) për përkthim.
3. Krijimi dhe blerja e programit/softuerit (bazës së të dhënave) për procesimin e ankesave.
4. Mbështetja e Organizatava Joqeveritare (OJQ) aktive në zbatimin e projekteve vetëdijësuese për promovimin e të drejtave gjuhësore.
5. Organizimi i konferencës së 5-të të Asociacionit Ndërkombëtar të Komisionerëve të gjuhëve.

Zyra e Komisionerit për gjuhët
www.komisioneri-ks.org

Zyra e Komisionerit për gjuhët është themeluar në prill 2012, me qëllim të ruajtjes, promovimit dhe mbrojtjes së gjuhëve zyrtare d.m.th. gjuhës shqipe dhe serbe, si dhe statusit të tyre të barabartë në Republikën e Kosovës, gjuhëve zyrtare në nivelin lokal (gjuhës boshnjake dhe turke) dhe të gjuhëve në përdorim zyrtar në komuna (gjuhës boshnjake, rome dhe turke), duke siguruar gjithashtu të drejtat gjuhësore të komuniteteve, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare.

Ndërtesa e Qeverisë
Kati VI nr.605 A
Rr. Nëna Terezë p. n
10000 Prishtinë, Kosovë

Ky raport është publikuar nga Zyra e Komisionerit për gjuhët/
Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në mars 2017.
Ky raport është në dispozicion në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.